



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:074864
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05702012

E.nr.1131/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditores Sh.H.A. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Zejnije Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e shtesës së papaguara, ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1131/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1131/23, të datës 24.08.2023 e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e shtesës së papaguar, ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:074864, të dt.12.01.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 22.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,713.70 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1131/23, më datë 15.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi